



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 22.12.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 20.12.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "ADL studio SHPK" për aktivitetin: "Konkurs projektimi për renovim infrastrukturor dhe artistik të tunelit të Kurrizit" dhe me numër të prokurimit: 616 -21-7371-223 nxjerr:

V E N D I M

Aprovohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit ekonomik "ADL Studio SHPK" e datës 20.12.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Konkurs projektimi për renovim infrastrukturor dhe artistik të tunelit të Kurrizit" dhe me numër të prokurimit: 616 -21-7371-223 .

1. **Anulohet** Njoftimi për anulim të aktivitetit i Autoritetit Kontraktues të datës 14.12.2021 dhe AK-ja do ta rivlerësoj aktivitetin;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "ADL Studio SHPK" me datë 20.12.2021 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Konkurs projektimi për renovim infrastrukturor dhe artistik të tunelit të Kurrizit" dhe me numër të prokurimit: 616 -21-7371-223 .

Autoriteti Kontraktues, me datë 22.12.2021 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimi i pare eshte i pjesërisht i bazuar, pasi qe juria edhe pse nuk ka pasë të drejtë të kërkoj sqarime, ka pasë të drejtën që ta vlerësoj koncept projektin e dorëzuar dhe nëse konstaton se i njejti është në pajtim me detyrat projektuese të kërkoj edhe dorëzimin në formën digjitale;

-Pretendimi i dytë nuk ka bazë pasi që në asnjë nen të përmendur nuk rregullohet rasti kur mungon ndonjë dëshmi lidhur me konkursin e projektimit, por me procedurat tjera të prokurimit;

-Pretendimi vijues lidhur me pikën 57.21 të RRUOPP-së është i bazuar, pasi që në interesin e AK-së parësore duhet të jetë përmbajtja e projektit që është pranuar në formë fizike e pastaj të kërkohej forma digjitale për të krahasuar a është identike me të njejtën.

Bazuar në sqarimet e dhëna për pretendimet tuaja u vendos si në dispozitiv. Kërkohej nga juria e re që së pari të vlerësoj përmbajtjen e projektit të dorëzuar e pastaj të vlerësohet a duhen informata shtesë apo jo.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi të këtij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

